

Ne perputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723/2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ky dokument eshte:



AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI

I

SHOQERISE

"AGE 33" SHPK

g



AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI

i

Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar

"AGE 33" Shpk

KAPITULLI I

Emri, Forma, Selia, Kohegzjatja

Neni 1. Data e Themelimit dhe Emri

- 1.1 Me anë të këtij akti, në datën e shënuar në fund të tij, themelohet shoqëria "AGE 33" (në vijim "Shoqëria"), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "Shpk", cili përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.2 Ortaket e Shoqërise ("Ortaket") gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërise të përfaqësuar në kuota.
- 1.3 Në të gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet të leshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, emri i saj do të ndiqet ose do të shoqërohet nga:
 - (i) fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "shpk".
 - (ii) numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) të saj.
 - (iii) adresa e regjistruar, dhe
 - (iv) dhe pasqyrimin e faktit që shoqëria është në procedurë likuidimi, në qoftëse ky rast paraqitet.
 - (v) Kapitalin e regjistruar të Shoqërise dhe kapitalin e paguar të Shoqërise

Neni 2. Forma Ligjore

- 2.1. Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ("shoqëri me përgjegjësi të kufizuar"), në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ("Ligji i shoqërive").

Neni 3. Selia

- 3.1. Selia e Shoqërise ndodhet në adresën: Malasej, Elbasan, Shqipëri, nr.pasurie 6/28/5, zona kadastrale 2559, vol 13, faqe 90. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërise. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësuese kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërise.

Neni 4. Kohegzjatja

4.1. Kohezgjatja e shoqërise është e pacaktuar.

KAPITULLI II

Neni 5. Objekti i Shoqërise

5.1. Objekti aktivitetit të Shoqërise të kryej çdo aktivitet prodhues e tregtar të lejuar nga legjislacioni Shqiptar, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- prodhim, tregti me shumicë e pakicë dhe import-export të produkteve të ndryshme drufrutore, bujqësore dhe blegtorale,
- transport, deponim, ruajtje, ambalazhim, paketim dhe spedicion të produkteve ushqimore e nenprodukteve të tyre për vetë e për të tretë;
- të bashkëpunojë e të bashkohet në sipërmarrje të përbashkëta me këto qofte tjetër person publik apo privat, juridik e fizik, vendas e të huaj që ka objekt veprimtarie të ngjashëm me objektin e kësaj shoqërie;
- të kontraktojë me persona fizike e juridike vendas e të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes për prodhimet dhe shërbimet e shoqërise.

5.2. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e sipërm, përfshirë, blerjen, marrjen me qira apo në përdorim e pasurive të paluajtshme.

Neni 6. Ndryshime

6.1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë vetëm me miratimin e ortakëve që përfaqësojnë 75% të kapitalit të Shoqërise.

KAPITULLI III

Kapitali Themeltar; Kuotat e Kapitalit Themeltar

Neni 7. Kapitali Themeltar

7.1. Kapitali i Shoqërise është në total 100 Leke, plotësisht të nënshkruara.

Neni 8. Ortakët e Shoqërise dhe Kuotat

8.1. Ortaku i Shoqërise dhe kuota e zotëruara prej tij në Shoqëri janë si më poshtë:

- (i) **Gerjon Gjoka**, atësia Gentjan, amësia Jonida, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në HIMARË, me adresë Palas, Dhermi 04200064; Nd. 197; H. 1; Himarë; Dhërmi; 9422; Himarë, lindur më 27/10/1999, gjendja civile "beqar", me nr. personal J91027040W që zotëron një kuote kuote, që përfaqëson 100 % të kapitalit të Shoqërise.

Neni 9. Zvogëlimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- 9.1 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogelohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortave, në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit të shoqërive.
- 9.2 Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me ane të kontributeve në para, me ane të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave (nëse ka) dhe fitimit.
- 9.3 Rritja e kapitalit do të bëhet me krijimin e kuotave të reja apo me rritjen e vlerës së kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit themelues do të nënshkruhen dhe vlera e tyre nominale do të paguhet plotësisht.
- 9.4 Zmadhimi i kapitalit nuk do të dobësojë pjesët e interesit të Ortave në Kapitalin e shoqërisë, përveçse kur Ortaket do të bëjnë dakord ndryshe me vendim unanim të Ortave.
- 9.5 Shoqëria nuk mund të blejë asnjë kuota të saj. Megjithatë me qëllim zvogelimit të kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet vendimit për zvogelimit të kapitalit, Ortaket mund të autorizojnë Administratorin/Administratoren të bëjnë blerjen e kuotave përkatëse apo pjesë të tyre dhe t'i anulojnë ato.

Neni 10. Te drejtat dhe detyrimet e Ortave

- 10.1 Ortaket janë vetëm ata të cilët zotërojnë kuotat e Shoqërisë.
- 10.2 Çdo Ortak do të ketë të drejtë vote në Asamblesën e Përgjithshme të Ortave ("Asambleja e Përgjithshme") në përputhje me vlerën nominale të kuotës që zotëron.
- 10.3 Te drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotave, transferohen tek çdo zotëruar i ri për këtë Kuota.
- 10.4 Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mund të jenë vetëm të mbajnë përgjegjësi brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë; Ortaket nuk mbajnë përgjegjësi që tejkalojnë investimin e tyre përkatës në kapitalin e Shoqërisë (përveç garancive dhe huave që ata realizojnë).
- 10.5 Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortave të tij.

Neni 11. Transferimi i pjesëve të Kapitalit

- 11.1 Pjesët e kapitalit transferohen lirish midis ortave.
- 11.2 Në rast se një Ortak do të shesë, transferojë, ose përdorë në mënyrë të ndryshme pjesë apo të gjithë kuotën e tij ortaku tjetër do të ketë të drejtën e parablërjes, kundrejt blerësve të tjerë. Nëse ortaku me të drejtë parablërjeje do të ketë bërë një ofertë dhe kjo ofertë është refuzuar nga Ortaku që shet, atëherë Ortaku që shet nuk do të ketë të drejtë të shesë kuotën tek një blerës tjetër me çmim më të ulët se çmimi i ofruar nga Ortaku i preferuar.
- 11.3 Çdo transferim i kuotave do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqërive dhe duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

KREU IV

Asambleja e Përgjithshme

Neni 12. Kompetencat

bc

12.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtues i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

Neni 13. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

13.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.

13.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

Neni 14. Menyra e Thirrjes

14.1 Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara saj nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

14.2 Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga cdonjeri prej Ortakeve.

14.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne seline e nje dege te Tiranes, Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi I dites perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjitha ortaket bien dakort.

14.4 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetër ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

14.5 Secili prej Ortakeve ka te drejten te votoje ne perputhje me kuoten e zoteruar prej tij ne kapital

14.6 Vendimet e meposhtme do te miratohen me voten e ortakeve qe zoterojne te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise:

- (i) Pagesa e cdo dividenti ne kesh apo natyre Ortakeve te Shoqerise;
- (ii) Nenshkrimi i marreveshjeve financiare ne lidhje me Shoqerine apo nxjerrja e instrumentave te borxhit nga Shoqeria;
- (iii) Blerja e cfaredolloj kuote apo interesi tjerter ne cdo biznes dhe sipermarrje;
- (iv) Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise sic eshte percaktuar ne Nenin 7 te kesaj Marreveshje;
- (v) Ndryshime dhe amendime te ketij Akti Themelimi dhe
- (vi) Likuidimi apo shperndarja e Shoqerise

14.7 Atehere kur ligji e kerkon kete, rezolutat e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter publik Shqiptar. Ne rast se keto rezoluta miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republikën e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen procedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).

- 14.8 Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.
- 14.9 Administratoret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 15 Perjashtimi nga e drejta e votes

- 15.1 Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:
- (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
 - (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
 - (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
 - (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
- 15.2 Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder ortaku te cilin perfaqeson.

KREU V

Administratoret

Neni 16. Bordi i Administratoreve dhe kompetencat

- 16.1 Shoqeria drejtohet Administratori. Administratoret mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezidente ne Shqiperi.
- 16.2 **Gerjon Gjoka**, atësia Gentjan, amësia Jonida, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në HIMARË, me adresë Palas Dhermi 04200064; Nd. 197; H. 1; Himarë; Dhërmi; 9422; Himarë, lindur më 27/10/1999, me nr. personal J91027040W, caktohet administratori i Shoqerise.
- 16.3 Kohezgjatja e funksionit te Administratoreve eshte per nje periudhe prej 5 vjetesh, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi prane Qendres Kombetare te Regjistrimit), me te drejte ripertesitje te ketij mandati.
- 16.4 Menjehere pas pranimit te emerimit te tyre, Administratori(et) njohin ne se maredhenia e tyre me Shoqerine ndertohtet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje rezolute te Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.
- 16.5 Ortaket kane te drejten te shkarkojne Adminsitratoret me shumice te thjeshte votash. Ortaket bien dakort se ne rastin kur nje administrator eshte njekohesisht dhe Ortak, Ortaku do te lejohet kurdohere qe te mund te votoje lidhur me shkarkimin apo jo te tij dhe Ortaket e tjere nuk do te ngren pretendim lidhur me kete votim te tij. Shoqeria do te konsiderohet e prishur dhe do te filloje likujdimin ne rast se cdo njeri prej Ortakeve ngre pretendime e kundertshton me procedura ligjore votimin e Ortakut qe eshte njekohesisht dhe Administrator, per shkarkimin apo jo te Administratorit te Shoqerise.



16.7 Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria u rimbursom Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Adminsitratorit(eve) ne vende qe nuk jane brenda qytetit te residences se Administratorit(eve).

Neni 17 Kompetencat dhe detyrimet

17.1 Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- (i) Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet e specifikuara ne nenin 13.
- (ii) Menaxhimin e aktivitetit tregtar te shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.
- (iii) Perfaqesimin e Shoqerise.
- (iv) Kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise.
- (v) Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblese se Pergjithshme.
- (vi) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, kur eshte e nevojshme.
- (vii) Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise.
- (viii) Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

17.2 Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.

Neni 18 Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia

18.1 Perverc sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,16,17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, administratoret detyrohen:

- (i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
- (ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- (iii) te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim.

Administrimi Financiar i Shoqerise

Neni 19. Eksperti Kontabel i Autorizuar

19.1 Ortaket mund te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar per t'i sherbyer Shoqerise.

19.2 Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII

Aktiviteti Shoqerise

Neni 20. Viti ekonomiko-financiar

20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-t te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

Neni 21. Mbajtja e Llogarive

21.1 Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

Neni 22. Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit

22.1 Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin, marreveshjen e Ortakeve dhe me ligjet e zbatueshme.

22.2 Nga fitimet vjetore, do te caktohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar per fondin rezerve te detyrueshem.

22.3 Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:

- (i) asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;
- (ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem;

22.4 Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.3 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

22.5 Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

KREU VIII

Modifikimi i Formes Ligjore; Prishja

Neni 23. Modifikimi i Formes Ligjore

23.1 Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

23.2 Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

Neni 24. Prishja e Shoqerise

24.1 Shoqeria mund të prishet në rrethanat e mëposhtme:

- (i) Në rast të parashikuara në këtë statut, sidomos në rastin kur Ortaket kundërshtojnë me procedurë ligjore votimin e një Ortaku i cili është njëkohësisht dhe administrator, lidhur me shkarkimin apo jo të administratorit të Shoqërisë;
- (ii) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- (iii) hapje e një procedure falimentimi;
- (iv) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr.9723, datë 3.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit";
- (v) me vendim gjykate;
- (vi) për arsye të tjera të parashikuara nga Ortaket në çdo kohë.

24.2 Administratori(et) regjistrojnë prishjen e Shoqërisë pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr.9723, datë 3.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit". Në rast se prishja e Shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr.9723, datë 3.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit", ia njoftimin vendimin kësaj të fundit për regjistrim.

KREU IX

Te ndryshme

Neni 25. Largimi i Ortakut

25.1 Largimi dhe përjashtimi i një Ortaku, si dhe pasojat që kjo sjell, do të rregullohen nga dispozitat nr. 101, 102, 103 të Ligjit të Shoqërive

Neni 26 Te tjera

26.1. Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë.

Nenshkrimi i Themeluesve/Ortakeve/Administratoreve

Gerjon Gjoka

Data 28/12/2020

Gerjon Gjoka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER VALBONA SH. SELIMI

DATE 28/12/2020

NR REP 7257

VËRTETIM NËNSHKRIMI



Para meje Notere VALBONA SH. SELIMI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.3, HOXHA TASIM, NR.292, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Gerjon Gjoka, atësia Gentjan, amësia Jonida, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në HIMARË, me adresë Palas Dhermi 04200064; Nd. 197; H. 1; Himarë; Dhërmi; 9422; Himarë, lindur më 27/10/1999, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaportën nr. personal J91027040W per identitetin e te cilit u sigurova, i cili nenshkroi Statutin dhe aktin e themelimit te Shoqerise Age 33 shpk bashkelidhur ketij vertetimi.

Ky vertetim leshohet nga une noterja ne baze te ligjit 'Per noterine' dhe udhezimit nr.7203 date 16.09.2009, pika 2 te Ministrit te Drejtesise.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
VALBONA SH. SELIMI

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Valbona Selimi', is written above a large, stylized blue scribble or flourish.